

## 10 gjërat që duhet t'i dini për COVID-19 dhe personat me aftësi të kufizuara

Grupi punues i Save the Children për gjithëpërfshirjen e aftësisë së kufizuar, 18 mars

Në disa vende dhe në nivel global, personat me aftësi të kufizuara kanë ngritur zërin lidhur me faktin që informacioni nga qeveria nuk është duke u ofruar në formate të qasshme apo që nuk po merren masa për të kompensuar zvoglimin e shërbimeve mbështetëse nga të cilat varen personat me aftësi të kufizuara. Raportuesja Speciale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka bërë një deklaratë që mund të lexohet [këtu](#).

### 1. Të gjitha përpjekjet për reagim dhe gatishmëri emergjente duhet të jenë gjithëpërfshirëse

Është thelbësore që të sigurohemi që të gjitha përpjekjet e bëra për frenimin e virusit dhe menaxhimin e rasteve janë gjithëpërfshirëse. Programimi gjithëpërfshirës përfshin **përhapjen e vetëdijes** për situatën e personave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe COVID-19. Ai po ashtu përfshinë **bërjen e të gjithë informacionit dhe aktiviteteve të qasshme**, në mënyrë që nga to të përfitojnë në manyrë të barabart personat dhe fëmijët me aftësi të kufizuara si çdokush tjetër. **Disa nga masat duhet që të shënjestrojnë në veçanti personat me aftësi të kufizuara**, të tilla si masat e mbrojtjes sociale për të ruajtur vazhdimësinë e strukturave mbështetëse. Ju mund të gjeni udhëzimet e IASC për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në veprim humanitar [këtu](#). Shumica aplikohen në të gjitha mjediset.

### 2. Personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat përfaqësuese të tyre duhet të përfshihen në të gjitha fazat e reagimit

Personat me aftësi të kufizuara janë ekspertët e vërtetë lidhur me atë se si të përfshihen grupet me dëmtime të ndryshme në të gjitha përpjekjet për reagim, gatishmëri, informacion dhe ofrimin e shërbimeve. Lëvizja për aftësinë e kufizuar e ka një slogan që thotë 'Asgjë për ne, pa ne', të cilin e përdorë për të përforcuar mesazhin që të gjitha gjërat që bëhen për të promovuar të drejta e personave me aftësi të kufizuara duhet të përfshijnë vetë personave me aftësi të kufizuara. Kjo është veçanërisht e vërtetë në kohëra të krizës kur masat për të mbrojtur grupet e përjashtuara dhe të stigmatizuara shpesh mbesin pas dore. Ju mund të gjeni një listë të organizatave përfaqësuese nga shumica e vendeve ku punojmë, [këtu](#).

### 3. Personat me aftësi të kufizuara janë një nga grupet më të rrezikuara

Edhe pse aftësia e kufizuar në vetvete nuk e vë një person në një grup të rrezikuar, personat me aftësi të kufizuara kanë më shumë të ngjarë të kenë gjendje shoqëruese kronike që mund të përkeqësojnë efektet e virusit. Informacioni lidhur me Koronavirusin është kudo, por ka ende pak informacion se çfarë duhet bërë nëse i përkisni një grupi të rrezikuar, duke rezultuar në numër të lartë thirrjesh nga persona me aftësi të kufizuara të cilët ndjehen të shqetësuar.

### 4. Të thuash "Mos u shqetëso, është i rrezikshëm vetëm për të moshuarit dhe ata/ato me gjendje shëndetësore para-ekzistuese ose kronike" është e papërshtatshme

Kjo formë e shprehjes nuk përputhet me qasjen e bazuar në të drejta të njeriut. Si organizatë, Save the Children mbështetë jo vetëm Konventën për të drejtat e fëmijës, por të drejtat e njeriut çdokur, si dhe Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kjo shprehje po ashtu ulë rëndësinë e vigjilencës për të frenuar virusin. Është e rëndësishme që fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe komplekse t'i mbrojmë nga mesazhe të tilla ku atyre iu referohet si pjesa e 'sëmiurë' apo 'më e dobët' e shoqërisë, pasi që kjo ka ndikim negativ në vetëbesimin dhe vetëvlerësimin.

### 5. Mesazhet e shëndetit publik DUHET të ofrohen në formate të ndryshme dhe të qasshme

Pasi që njerëzit komunikojnë dhe kuptojnë informacionin ndryshe, është absolutisht thelbësore që informacioni të ofrohet përmes një game të formateve të komunikimit. Në të kundërtën, gjërat mund të shkojnë keq. Informacioni, përveç të qenit miqësor për fëmijë, duhet gjithashtu të përfshijë audio, [shkronja](#)

[të mëdha](#), [lexim që kuptohet lehtë](#), [fotografi](#) dhe [gjuhë të shenjave](#). Linjat telefonike të informacionit duhet të ekzistojnë në formë të tekstit dhe postës elektronike për ata/ato që kanë vështirësi në dëgjim. Shiko shembujt në secilën vegzë.

## **6. Ndërprerja e rutinave mund të jetë e vështirë për fëmijët në Spektrin e Autizmit apo të tjerët që kërkojnë rutina të qëndrueshme**

Me ndërprerjen e rutinave ditore të tilla si mos shkuarja në shkollë, mos dalja për shëtitje ditore apo pamundësia për qasje në ushqimin e zakonshëm, mund të bëjë që familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përjetojnë nivel të lartë të stresit dhe shpesh të kenë nevojë për mbështetje shtesë. Shumë fëmijë ose prindër janë mësuar me struktura të caktuara të cilat, kur ndërpriten, mund të shkaktojnë sfida në shtëpi dhe për më tepër t'i vendosin fëmijët me aftësi të kufizuara dhe motrat e vëllezërit e tyre në rrezik më të lartë të shqetësimit ose abuzimit.

## **7. Qasja në mjekimin e rregullt mund të bëhet më e vështirë**

Shumë fëmijë me aftësi të kufizuara kërkojnë receta dhe ilaçe të rregullta për të qëndruar të shëndetshëm dhe funksionalë. Me ndërprerjen e sistemeve shëndetësore dhe shërbime të zvogëluara nga klinikat shëndetësore që ofrojnë kujdes standard, fëmijët me aftësi të kufizuara mund të mbesin pa ilaçet e rëndësishme për të qëndruar të shëndetshëm. Kjo është veçanërisht e vërtetë ku shërbimet shëndetësore veçse diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara për shkak të koncepteve të gabuara stigmatizuese apo mungesës së vetëdijes.

## **8. Personat me aftësi të kufizuara mund të mos jetë në gjendje që të ndjekin masat e rekomanduara se si të mbrojnë vetveten**

Shumë persona me aftësi të kufizuara mbështeten në ndihmë dhe përkrahje nga të tjerët për të bërë gjëra gjatë ditës. Kjo përfshinë larjen e duarve, ngrënie, veshjen, mbajtjen e diçkaje për të mbuluar hundën dhe gojën gjatë teshtitjes, hudhjen e faculetës në kosh të plehrave, larjen e rrobave, etj. Kur keni nevojë për dikë që të ju mbështesë në rutinën tuaj të përditshme, mund të mos jetë e mundur që të vetë-izoloheni përgjatë ditës apo të merrni masat e nevojshme për distancim social. Furnizimi me ushqime apo dërgimi i ushqimeve në shtëpi kur në të njëjtën kohë ke nevojë për ndihmë, shndërrohet në një sfidë shtesë. Fëmijët janë veçanërisht të ndjeshëm, por edhe fëmijët e vegjël të prindërve me aftësi të kufizuara mund të afektohen.

## **9. Përhapja e koronavirusit mund të zvogëlojë pavarësinë dhe të rrisë ndjeshmërinë**

Mbështetja dhe përkrahja personale është qenësore për shumë persona me aftësi të kufizuara për të jetuar në mënyrë të pavarur. Situatat e karantinimit dhe distancimit social mund të dobësojnë sistemin dhe rrjetin e mbështetjes që ka për qëllim përkrahjen e personave me aftësi të kufizuara që të jetojnë të pavarur në shtëpi. Jetesa e përditshme mund të ndikohet më tej nëse personeli kryesor ose anëtarët e familjes infektohen dhe kështu nuk mund të kryejnë detyrat e tyre të rregullta mbështetëse. Të gjithë kemi dëgjuar për djalin 16 vjeçar në Kinë që jetonte me paralizë cerebrale dhe i cili vdiq për shkak të neglizhencës kur babai i tij u fut papritmas në karantinë duke pamundësuar që të kryente aranzhimet për djalin e tij. Një vendim për të vënë veten dhe një kujdestar ose ndihmë në rrezik e komplikon më tej situatën. Kjo është veçanërisht e vërtetë në qendrat rezidenciale. Ndërprerja e kontakteve me të dashurit dhe rrjetet mbështetëse mund t'i lë personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht fëmijët, plotësisht të pambrojtur nga çdo formë abuzimi.

## **10. Mbyllja e shkollave rezidenciale dhe qendrave ditore mund të vë personat me aftësi të kufizuara në rrezik ndaj abuzimit**

Në raste të mbylljes së shkollave rezidenciale dhe qendrave ditore apo anulimit të shërbimeve, duhet të merren masa për të forcuar kujdesin dhe aktivitetet shëpiake. Meqenëse fëmijët me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për kujdes shtesë krahasuar me fëmijët e tjerë, familjet të cilat nuk janë mësuar ta kenë fëmijën në shtëpi gjatë gjithë kohës mund të hasin në vështirësi, gjë që mund ta vë fëmijën në rrezik nga abuzimi, neglizhenca dhe dhuna. Ndryshimet e papritura dhe të paparashikuara tek ofruesit e kujdesit parësor dhe rrjetet e sigurisë mund të shkaktojnë më tej dëm psikologjik tek fëmija.